



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 34 Datë 13-03-2026**

**“PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE  
PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË  
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “STIMULIMI I INDUSTRIVE KREATIVE NË  
QYTETIN E KORÇËS”**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, urdhërin nr. 12 datë 7.1.2026 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2026 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve, sipas programeve dhe produkteve, marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë, e lidhur më date 9.2.2026 me nr. 1292 prot., Vendimi I Këshillit të Qarkut Nr. 50 datë 23.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit të “Stimulimi i Industriave Kreative në qytetin e Korçës”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave të financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë në vlerën 4,000,000 lekë.
2. Të miratojë përdorimin e kontributit financiar nga Këshilli i Qarkut Korçë, për zbatimin e projektit “Stimulimi i Industriave Kreative, në qytetin e Korçës”, pagesat e qirave të ambienteve që do të perdoren për ushtrimin e aktiviteteve të artizanëve, prodhuesve të rinj kreative me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET Prog. AC122 00 Prod. V476AAB 05 Art. 6020000 + 4,000,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Pro 24

Vota Kundër 2

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 13-03-2026

KRYETAR

Ana Verushi

